V E N D I M
Nr.530, datë 14.11.1999

PËR PËRJASHTIMIN NGA PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË OBJEKTIT TË ISH-REPARTIT USHTARAK 7306, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", ndryshuar me ligjin 8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të përjashtohet nga procedura e privatizimit objekti i ish- Repartit Ushtarak nr.7306 Tiranë.
2. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik të hartojnë procedurat përkatëse për kalimin e këtij objekti në administrimin e Ministrisë së Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta